



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2020:014097
Datë: 26.02.2024
Numri i dokumentit: 05376801

KF.nr.108/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtaren Vera Gashi Bala, në kontestin tregtar - administrativ të paditësit “Global Construcion” Sh.P.K., me numër të regjistrimit të biznesit 70544881 dhe seli në rr. “Muharrem Fejza” në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson B.K. kontabilist i certifikuar, kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës, me seli në Prishtinë, me bazë ligjore anulim vendimi, jashtë seancës gjyqësorë, me datë 26.02.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. HEDHET POSHTË padia e paditësit “Global Construcion” Sh.P.K., me seli në Prishtinë, e ushtruar kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës, për shkak se paditësi nuk e ka plotësuar ankesën-padinë sipas aktvendimit të gjykatës KF.nr.108/22 të datës 28.02.2023.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

Paditësi “Global Construcion” Sh.P.K., me seli në Prishtinë, me datë 31.01.2020, në Gjykatën Themelore Prishtinë, Departamenti Administrativ, Divizioni Fiskal, ka ushtruar padi kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës, me të cilën ka kërkuar që të anulohet raport ri-kontrolli i lëshuar nga inspektori i të paditurës.

Pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Gjykatën Komerciale të Kosovës, lënda është transferuar nga Gjykata Themelore Prishtinë, Departamenti për çështje Administrative – Divizioni Fiskal në Gjykatën Komerciale të Kosovës për shqyrtim të mëtejme në bazë të kompetencës lëndore, dhe e njëjta ka marrë numrin KF.nr108/22.

Gjykata pas shqyrtimit paraprak të padisë, shqyrtoj lejueshmërinë dhe rregullsinë e padisë së paditësit dhe pas shqyrtimit të së njëjtës dhe shkresave të tjera të lëndës konstatoi se padia është e parregullt.

Rrjedhimisht, kjo Gjykatë me datë 28.02.2023 ka marr aktvendim me të cilën ka kërkuar që paditësi në afatin prej 8 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktvendimi të bëjë rregullimin e padisë, ashtu siç është kërkuar në kuptim të nenit 32.1 të Ligji nr. 03/1-202 për konfliktet administrative (LKA-së), me paralajmërim se në të kundërtën padia do të hedhet poshtë në kuptim të dispozitës së nenit 33.2 të LKA-së.

Nga fletë kthesa për dorëzim personal, vërtetohet se i autorizuari i paditësit aktvendimin KF.nr.108/22 të datës 28.02.2023 për rregullim të padisë e ka pranuar me datë 31.03.2023, ndërsa as në afatin e përcaktuar nga gjykata e as deri me nxjerrjen e këtij aktvendimi, nuk e ka bërë rregullimin e padisë.

Gjykata, konform dispozitës nga neni 33 par .2 të LKA-së, parashihet se *“Nëse paditësi, brenda afatit të cekur, nuk i mënjanon të metat e padisë, kurse ato janë të atilla që e pamundësojnë zhvillimin e procedurës, gjykata do ta hedhë poshtë me vendim padinë, nëse nuk konstaton se akti administrativ i kontestuar është i pavlefshëm”*, e ka hedhur padinë e paditësit për shkak se paditësi nuk e ka plotësuar ankesën-padinë sipas aktvendimit të gjykatës KF.nr.108/22 të datës 28.02.2023.

Vendimi për shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 64 të LKA-së.

Nga të cekurat më lart e konform nenit 33 par.1 dhe 2 të LKA-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal

KF.nr.108/22, datë 26.02.2024

Gjyqtarja
Vera Gashi Bala

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktvendimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.